



Farat e liga zânë rraj' thellë.

Doracaku "Farat e Rrejshme", i marum n'bashk-punim me artistin Driton Selmani, është një udhëzues vizual që ka për qëllim me i ndihmu njerzt me i pa e kuptu praktikat korruptive që shpesh fshihen mrapa sipërfaqes. Ky manifest me 11 pika është i plekun për me tregu se si edhe një veprim a send i vogël mundet me kenë pjesë e marrveshjeve t'fshehuna, që bâhen mrapa dyrve t'mbylluna, ose pjesë e "farave" që jan' subvencionu me hile.

Me ilustrime që tregojnë situata t'ditshme, ky doracak jep një rrugë t'lehtë vizuale me kuptu si dukuritë që doken t'pafajshme janë lidhë me ndikime t'padukshme, e që i ndihmon ujdit' e errta. Gjuha ironike përdoret për me zgju vetdijen e njerzve, me i ba me kuptu ndikimet që shpesh kalojnë pa u vretjtë, e me u fuqizu për me i pa e shmangë kto marrveshje t'mshefta që ndikojnë n'jetën e përditshme.

Farat e Rrejshme është një mjet për me pru dritë n'një shoqni ma t'drejtë e ma t'pastërt, tu ofru kuptime t'lehta e t'qarta për me luftu padrejtsitë e për me promovu ndershmminë e përgjegjësinë.




Farat e Rrejshme
(2024)

Mos mbaj pare nën tavolinë;
dora poshtë është deklaratë

*Refuzo marrëveshjet e mshefta.
Çka nuk thuhet n'zâ, nuk duhet bâ.




Parja n'gishta s'paguen
peshën e ujdisë



*Mos prano dallavere.
Paguaj çka t'takon, jo çka pëshpëritet n'vesh.


Nji send i vjedhun nuk ka
peshë n'dorën tande



*Çka fiton prej mashtrimeve, asht e zbrazët.
Pesha e saj t'rron në dhe.

S'munesh me korrë nder'
prej farave t'vjedhuna


*Puno me njersë; ndamjet e shpejta
t'kafshatës nuk shkojnë kurrkund.



Gaci n'est pas un buki.

Paret e përlyme s'bâhen t'pastra,
sado her' t'i lajsh n'ujë t'paqt

*Vnoj menën rrjedhës,
se ky uj' e myt' shoqnin'.



Me marrë frytet e tjetrit,
nuk t'ban kopshtar


*Mos merr punën e dikujt tjetër.
Pema thahet ku fillon mashtrimi.

Mshtetja nuk
â për kushrî!

*Shpërndaje buxhetin e shtetit drejt,
jo te ata me mbiemën "t'duhun".



Çka rrin nën hije,
s'ka vend n'dritë



*Mos ngatërro ose maro dokumente.
Rrenat djegen n'dritën e ditës.

Dora e padukshme
dridhet mâ fort.




*Ujditë e mshefta nuk janë t'padukshme
— ulërasin kur hajnia afrohet ngat.

Kush ndihmon veç
ata që japin, nuk
ndihmon kurrkënd

*Jep shërbime pa prit ryshfete.
Zemërgjanësia s'është tregti.



Pasunia publike s'asht
hallvë për t'pangopunit



*Neroje venin; nuk asht për me u përbî si me kâ âmbëlsi vetjake.

Farat e rrejshme
s'rriren n'tokë t'hileve



*Mos përdor pasunin' me mbjellë veç për t'mirën e fisit tan'.

